



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**ZËVENDËSGUVERNATORI I PARË**

Nr. Prot. 5438

Tiranë, më 26.12.2023

**URDHËR**  
Nr. 5438, datë 26.12.2023

**PËR**  
**MIRATIMIN E METODOLOGJISË**  
**“PËR RAPORTIMIN E INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, pika 5 të Statutit të Bankës së Shqipërisë miratuar me vendimin nr. 90, datë 2.12.2015 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar; nenit 3, pika 8 dhe nenit 5, pika 3 të rregullores “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar” miratuar me vendimin nr. 45 datë 10.6.2009 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar; nenit 6, pika 1 të rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës” miratuar me vendimin nr. 19, datë 26.2.2014 të Këshillit Mbikëqyrës, i ndryshuar, dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës:

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e metodologjisë “Për raportimin e instrumenteve të pagesave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës me ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri dhe me dërgimin e këtij urdhri të gjitha bankave dhe degëve të bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij urdhri në Buletinin Zyrtar dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, shfuqizohet urdhri me nr. prot. 43, datë 9.1.2014 "Për miratimin e metodologjisë "Për raportimin e instrumenteve të pagesave" i Zëvendësguvernatorit të Parë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSGUVERNATOR I PARË**

**LULJETA MINXHOZI**

## METODOLOGJIA “PËR RAPORTIMIN E INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE”

### I. TË PËRGJITHSHME

Në përmbushje të funksionit të saj publik si mbikëqyrës dhe katalizator i sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë mbledh informacion mbi tregues cilësorë dhe sasiorë në fushën e sistemit të pagesave, në mënyrë që të kryejë një mbikëqyrje efektive si dhe të nxisë zhvillimet në këtë fushë. Grumbullimi, përpunimi dhe publikimi i këtyre treguesve statistikorë mundëson analizimin e tendencave, monitorimin e zhvillimeve, minimizimin e rrezikut si dhe transparencën ndaj publikut. Metodologjia për raportimin e instrumenteve të pagesave, e hartuar nga Banka e Shqipërisë, synon ndërtimin e një baze të dhënash mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave në funksion të objektivave të lartpërmendur.

Metodologjia “Për raportimin e instrumenteve të pagesave” hartohet në zbatim të nenit 5, pika 2, shkronja “d”, dhe pika 3, e rregullores nr. 45 datë 10.6.2009 “Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar”, i ndryshuar. Raportimi sipas kësaj metodologjie zbatohet për formularët e përcaktuar në aneksin 5 të rregullores, i detyrueshëm për t’u plotësuar dhe për t’u paraqitur në Bankën e Shqipërisë nga subjektet raportuese (përcaktuar në pikën III, “Procedura për grumbullimin dhe paraqitjen e raporteve nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, të këtij dokumenti).

Struktura e metodologjisë është ndërtuar duke u bazuar në llojet e instrumenteve të pagesave, në tipet e transaksioneve, në llojet e terminaleve ku përdoren instrumentet e pagesave, si dhe sipas llojit të autentifikimit të përdorur<sup>1</sup>. Kjo metodologji është hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura nga Banka Qendrore Evropiane (*Blue Book*) dhe Banka për Rregullimet Ndërkombëtare – BIS (*Red Book*).

#### Metodologjia përfshin:

- a) formularët për raportim;
- b) procedura për grumbullimin dhe paraqitjen e raportit;
- c) instruksione mbi raportimin sipas formularëve bashkëlidhur;
- d) shpjegimin e termave sipas kuptimit që ato kanë në këtë metodologji.

<sup>1</sup> Raportimi sipas llojit të autentifikimit të përdorur i referohet rregullores nr. 29, datë 01.06.2022 “Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurt të komunikimit”.

## II. FORMULARËT PËR RAPORTIM

Formularët që duhet të plotësohen në funksion të raportimit për përdorimin e instrumenteve të pagesave janë përcaktuar në Aneksin 5 të rregullores nr. 45, datë 10.6.2009 "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar", e ndryshuar. Ato gjenden bashkëlidhur kësaj metodologjie dhe janë pjesë përbërëse e saj, si më poshtë:

- Formulari 1. Pagesat sipas instrumenteve;
- Formulari 2. Transaksionet sipas tipit dhe terminaleve;
- Formulari 3. Transaksione *cash* në arkë;
- Formulari 4. Transaksione periodike në sistem (*book entry*);
- Formulari 5. Kartat bankare;
- Formulari 6. Terminalet për kartat dhe paranë elektronike;
- Formulari 7. Statistika mbi numrin e llogarive të klientëve;
- Formulari 8. Statistika mbi mbajtësit e kartave;
- Formulari 9. Statistika mbi shpërndarjen rajonale të terminaleve;
- Formulari 10. Teprica e parasë elektronike; dhe
- Formulari 11. Transaksionet e pagesave sipas llojit të autentifikimit të përdorur.

## III. PROCEDURA PËR GRUMBULLIMIN DHE PARAQITJEN E RAPORTEVE NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA

1. Subjekte të raportimit mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave<sup>2</sup> janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat operojnë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Periodiciteti dhe afati i raportimit është si më poshtë:

Periodha për të cilën raportohet është nga data 1 deri në datën e fundit të çdo muaji.

- Formularët **1, 2, 3 dhe 4** raportohen çdo muaj nga bankat jo më vonë se data 15 e muajit pasardhës.
- Formularët **5 dhe 6** raportohen çdo tre muaj nga bankat jo më vonë se data 25 janar, 25 prill, 25 korrik dhe 25 tetor.
- Formularët **7, 8, 9 dhe 10** raportohen nga bankat çdo fund viti, dhe afati i raportimit është **jo më vonë** se data 25 janar e vitit pasardhës.
- Formulari 11 raportohet çdo tre muaj nga bankat **jo më vonë** se data 25 janar, 25 prill, 25 korrik dhe 25 tetor.

<sup>2</sup> Në reference të Aneksit 5 të rregullores nr. 45 datë 10.6.2009 "Mbi raportimet në Bankën e Shqipërisë sipas Sistemit Raportues të Unifikuar", e ndryshuar.

3. Formularët dërgohen në formë elektronike nëpërmjet Sistemit Elektronik Raportues Rregullator - ERRS. Përpunimi i të dhënave realizohet nga Sektori i Licencimit, Politikave dhe Mbikëqyrjes pranë Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës. Gjithashtu komunikimet për sa më sipër kryhen nëpërmjet adresës së mëposhtme të postës elektronike:

Statistika-IPE@bankofalbania.org

4. Njësia monetare e raportimit është **LEK**-u. Raportimi bëhet i veçantë për secilin instrument dhe secilën valutë, sipas njësisë monetare nëpërmjet të cilës kryhet pagesa si: ALL, USD, EUR dhe valuta të tjera. Konvertimi i pozicioneve të valutave të huaja në LEK bëhet me kursin zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në ditën e fundit të periudhës raportuese. Raportimi për formularët (1-10) përfshin volumin (numrin e pagesave) dhe vlerën e tyre në total, e shprehur në lekë, me përjashtim të formularit 11, ku vlera e transaksioneve raportohet në milionë lekë.
5. Në të gjithë formularët e kësaj metodologjie, raportimi do të kryhet në monedhën në të cilën ndodh pagesa dhe jo në monedhën në të cilën është llogaria e prekur për kryerjen e saj.
6. Banka e Shqipërisë publikon të dhënat e raportuara nga bankat në mënyrë të agreguar, përveç rasteve kur ky informacion përdoret për arsye analizash dhe studimesh, si dhe për përmbushjen e funksioneve të autoriteteve mbikëqyrëse që lidhen në mënyrë direkte apo indirekte me fushën e sistemit të pagesave. Në këtë rast, Banka e Shqipërisë njofton subjektet raportuese të kësaj metodologjie.
7. Bankat raportojnë në përputhje me afatet dhe formën e përcaktuar në këtë metodologji. Në rast mosrespektimi të kësaj metodologjie dhe cenimit të mbarëvajtjes së funksioneve të saj, Banka e Shqipërisë merr masa të parashikuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ.
8. Kjo metodologji do të rishikohet nga Banka e Shqipërisë sa herë të konsiderohet e nevojshme, duke marrë masa paraprake për konsultimin dhe informimin e bankave.

#### **IV. INSTRUKSIONE PËR HARTIMIN E RAPORTEVE SIPAS FORMULARËVE BASHKËLIDHUR NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA**

##### **FORMULARI 1: PAGESAT SIPAS INSTRUMENTEVE**

Formulari i parë i raportimit përbëhet nga 10 (dhjetë) rubrika, ku paraqiten numri dhe vlera e pagesave sipas instrumentit të përdorur

për të kryer pagesën, brenda ose jashtë vendit. Në këtë formular, do të raportohen transfertat për lëvizjen e fondeve të iniciuara nga klienti pranë bankës së tij (banka raportuese), ku klienti mund të jetë në rolin e urdhëruesit apo të përfituesit të fondeve. Në këtë formular përfshihen edhe transfertat në të njëjtin emër, por vetëm kur ato kryhen në llogari të bankave të ndryshme. Në këtë formular nuk raportohen transaksionet e iniciuara nga banka<sup>3</sup>, me përjashtim të rasteve kur këto transaksione konsistojnë në pagesa vetëm të bankës (detyrime utilitare, paga etj.). Raportimi bëhet i ndarë sipas valutave: në ALL, EUR, USD dhe valuta të tjera. Gjithashtu, ky formular përfshin dhe ndarjen më vete në llogaritë për individë dhe llogaritë për bizneset (aty ku është e nevojshme).

## I. Transferta kreditimi të iniciuara nga klientët

Në rubrikën e parë, raportohen transfertat e kreditimit të iniciuara nga klienti pranë bankës raportuese, të ndara sipas mënyrës në të cilën klienti dërgon instruksionet, në formë letër apo në formë elektronike, si më poshtë.

Gjithashtu, në këtë rubrikë përfshihen edhe transfertat e kreditimit të urdhëruara nga klienti për shlyerjen e detyrimit të kartave me funksion krediti apo debitimi të vonuar meqenëse konsiderohen si pagesa të ndara nga ato të kartë-mbajtësit për lëshuesin e tyre.

Në rastet e pagesave periodike apo urdhër pagesave në formën e *batch*-eve, çdo pagesë individuale llogaritet si një transaksion.

*Transfertë krediti në formë letër:* Raportohen vetëm transfertat e kreditit të urdhëruara nga klienti në formë letër. Gjithashtu, këtu raportohen edhe transfertat e kreditit të urdhëruara nga klienti në formë elektronike, por që kërkojnë procesim manual nga punonjësit e bankës për t'u ekzekutuar.

Ndër transfertat e kreditit në formë letër, të cilat ndahen në individë dhe biznese, mund të përmendim:

- § Transferta ndërmjet llogarive të së njëjtës bankë: raportohen transfertat llogari në llogari brenda së njëjtës bankë.
- § Transferta ndërbankare brenda vendit: raportohen transfertat të cilat kalojnë nga një llogari e një banke (banka raportuese), tek një llogari në një bankë tjetër brenda vendit.

*Transfertë krediti në formë jo-letër:* Raportohen vetëm transfertat e kreditit të urdhëruara nga klienti në formë elektronike dhe që nuk kërkojnë ndërhyrjen manuale të punonjësit të bankës për t'u ekzekutuar. Në këtë rubrikë, përfshihen edhe transfertat periodike të cilat janë origjinuar në formë letër, por që janë ekzekutuar në formë elektronike. Në këtë zë

<sup>3</sup> Si për shembull transaksione të iniciuara me qëllim përmbushjen e aktivitetit të saj bankar/financiar.

përfshihen edhe transfertat e kreditimit të kryera nga një klient nëpërmjet një ATM-je (*Automated Teller Machine*).

Këto transfertat klasifikohen sipas mënyrës së marrjes së urdhërpagesës:

- § nëpërmjet internetit (*internet banking*);
- § nëpërmjet telefonit (*telephone banking*);
- § nëpërmjet celularit (*mobile banking*);
- § nëpërmjet kompjuterit (*computer banking*);
- § Të tjera: këtu raportohen të gjitha transfertat e kryera në formë elektronike por që nuk përfshihen tek ndonjë nga zërat e përmendur më sipër.

## II. Pagesa të iniciuara nga klientët me kartë

Në këtë rubrikë raportohen pagesat të cilat kryhen nga klienti me anë të një karte të lëshuar nga banka raportuese. Pagesat me këto karta kryhen në të gjitha терминаlet (pikat e shitjeve POS) ose nëpërmjet kanaleve të tjera të ofruara nga banka (brenda ose jashtë vendit), si për shembull pagesat me karta nëpërmjet internetit, celularit. Këtu nuk përfshihen pagesat me para elektronike si dhe pagesat me celular, në internet, etj.. Tërheqjet dhe depozitimet në ATM, transfertat nëpërmjet ATM-ve si dhe tërheqjet *cash* nga POS-et nuk përfshihen në këtë rubrikë. Pagesat e kryera me karta të lëshuara nga banka të tjera, në терминаlet POS të ofruara nga banka raportuese nuk përfshihen në këtë rubrikë, pasi ato raportohen nga banka përkatëse, e cila ka emetuar kartën.

Sipas funksioneve që kanë, pagesat me këto karta ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- § Kartë debiti – i lejon mbajtësit të autorizuar të ketë akses në llogarinë e tij pranë emetuesit për të kryer blerje me fondet e disponueshme në këtë llogari si edhe për të tërhequr para *cash*, në rastet kur kjo kartë është e kombinuar me kartën me funksion *cash*-i;
- § Kartë me debitim të vonuar – e ngjashme me kartat e debitit, përveç faktit që shlyerja e pagesës në llogari bëhet në total, në një periudhë të përcaktuar kohe, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë;
- § Kartë krediti – i jep mundësinë mbajtësit të saj të përdorë një linjë krediti nëpërmjet së cilës mbajtësi mund të bëjë blerje dhe/ose të tërheqë *cash* deri në një kufi të paracaktuar. Sasia e lejuar e kreditit, si rregull shlyhet e plotë në fund të një periudhe të caktuar, ose mund të shlyhet pjesërisht dhe e shtyrë në kohë, në përputhje me termat e përcaktuara në kontratë;
- § *Charge cards* – e ngjashme me kartat e kreditit, përveç faktit se shlyerja e kredisë bëhet e plotë dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Për qëllime statistikore klasifikohen si karta krediti.

### III. Debitimi direkt

Këtu përfshihen debitime të autorizuar paraprakisht, kryesisht periodike, të llogarisë së debituesit nga ana e përfituesit. Përfshihen debitimet e kryera vetëm një herë dhe ato periodike. Në rastin e debitimit direkt periodik, çdo pagesë individuale llogaritet si një transaksion i vetëm. Gjithashtu, në këtë rubrikë përfshihet edhe shlyerja e detyrimeve të kartave me funksion krediti apo debiti të vonuar, pasi konsiderohen pagesa të veçanta nga mbajtësi i kartës për emetuesin e kartës. Debitimet direkte, të cilat rrjedhin nga shlyerja e një pagese me kartë individuale, nuk duhet të raportohen për shkak të rrezikut të numërimit të dyfishtë. Debitimi direkt raportohet nga banka e përfituesit.

### IV. Pagesa me para elektronike

Në këtë rubrikë raportohen pagesat me para elektronike, të iniciuara nga mbajtësi i parasë elektronike (urdhëruesi) në favor të përfituesit. Këto pagesa raportohen të ndara në: (1) pagesa me para elektronike nëpërmjet një karte, (2) pagesa me para elektronike të tjera si (në formën e produkteve të parapaguara kompjuterike).

### V. Çeqet

Pagesat me çeqe raportohen nga banka, ku përfituesi ka paraqitur çekun për rimbursim të parave nga ky çek. Në këtë rubrikë raportohen të gjitha llojet e çeqeve, si ato bankare apo personale, por edhe lloje të tjera si çeqe udhëtimi apo nota premtimi të lëshuara nga bankat (në rast se ka të tilla). Këtu raportohen edhe tërheqjet *cash* me anë të një çeku. Çeqet e emetuara, por jo të pranuar për shlyerje nuk përfshihen.

### VI. Pagesa me instrumente të tjera

Në këtë rubrikë përfshihen pagesat e klientëve me instrumente të tjera, të cilat nuk përfshihen në asnjë nga pikat më lart.

### VII. Totali i pagesave të klientëve

Është shuma e pagesave të raportuara në rubrikat e mësipërme (I –VI).

Nga totali i pagesave të klientëve të raportuara, në rubrikën VII.1 raportohen vetëm pagesat ndërkombëtare të klientëve, të cilat banka raportuese dërgon/inicion për llogari të një klienti, në një bankë të huaj. Transfertat e kreditimit raportohen nga banka e urdhëruesit (përfituesi i fondeve është klient i një banke jashtë vendit); debitimi direkt dhe çeqet raportohen nga banka e përfituesit (pagesa iniciohet nga përfituesi pranë bankës raportuese dhe banka e urdhëruesit ndodhet



jashtë vendit), si dhe pagesat me karta raportohen nga banka emetuese e kartës (pagesa është kryer jashtë territorit të Shqipërisë me një kartë të emetuar nga banka raportuese).

### **VIII. Transferta ndërkombëtare të mbërritura në llogarinë e klientit**

Në këtë rubrikë raportohen transfertat ndërkombëtare në hyrje, që banka raportuese proceson për klientët e saj. Këto transfertat raportohen nga banka e përfituesit (urdhëruesi i fondeve është klient i një banke jashtë vendit); debitimi direkt dhe çeqet raportohen nga banka e urdhëruesit (pagesa iniciohet nga përfitues i cili është klient i një banke jashtë vendit), si dhe pagesat me karta raportohen nga banka pranuese e kartës (pagesa është kryer në терминаlet e ofruara nga banka raportuese nëpërmjet një karte të emetuar nga banka jashtë vendit).

### **IX. Transferta ndërbankare**

Në këtë rubrikë raportohen të gjitha transfertat ndërbankare të iniciuara nga banka raportuese, ku urdhëruese mund të jetë vetë banka raportuese ose një bankë tjetër. Transfertat ndërbankare do të përfshijnë të gjitha transfertat ndërmjet bankave dhe/ose bankës qendrore, brenda vendit dhe ato ndërkombëtare. Transfertat për tregun financiar në lekë kryesisht kryhen nëpërmjet sistemit AIPS.

Nga totali i transfertave ndërbankare, në rubrikën IX.1 raportohen vetëm transfertat ndërkombëtare të iniciuara/dërguara nga banka raportuese (urdhëruese) për një bankë përfituese të huaj, jashtë vendit. Raportimi do të bëhet në monedhën që kryhet transaksioni.

### **X. Transferta ndërkombëtare të mbërritura në bankë (nga një bankë tjetër)**

Në këtë rubrikë raportohen transfertat ndërbankare ndërkombëtare në hyrje, që banka raportuese pret nga një bankë jashtë vendit (banka urdhëruese).

## **FORMULARI 2: TRANSAKSIONET SIPAS TIPIT DHE TERMINALEVE**

Ky formular përfshin raportimin në numër dhe vlerë të transaksioneve me karta në terminale, pavarësisht nga valuta e origjinimit të tyre. Llojet e transaksioneve të cilat raportohen në këtë formular, janë si më poshtë:

- I. Transaksione të kryera në терминаlet e vendosura në vend, me anë të kartave të emetuara nga banka raportuese;
- II. Transaksione të kryera në терминаlet e vendosura jashtë vendit, me anë të kartave të emetuara nga banka raportuese; dhe
- III. Transaksione të kryera në терминаlet e vendosura nga banka raportuese, me anë të kartave të emetuara nga banka jashtë vendit.

Në secilën nga rubrikat e mësipërme, pavarësisht valutës së origjinës së transaksionit, transaksionet raportohen në monedhën Lek, të ndara sipas tipeve të mëposhtme:

1. ATM tërheqje *cash*;
2. ATM depozitime;
3. Transferte fondesh nëpërmjet ATM-ve;
4. Tërheqje *cash* në terminale POS;
5. Pagesa me karta në terminale. Në këtë zë përfshihen vetëm pagesat me kartë në pikat e shitjes, ndërkohë që pagesat nëpërmjet kanaleve të tjera të ofruara nga banka (brenda ose jashtë vendit), si për shembull pagesat me karta nëpërmjet internetit, ose celularit nuk raportohen në këtë zë.
6. Transaksione në terminale për mbushjen dhe shkarkimin e parasë elektronike. Këto transaksione mundësojnë transmetimin e vlerës së parasë elektronike nga emetuesi te përdoruesi dhe të kundërtën. Emetimi i parasë elektronike mund të bëhet nëpërmjet kartave ose programeve dhe pajisjeve kompjuterike.
7. Pagesat me para elektronike të cilat mund të bëhen nëpërmjet kartave ose pajisjeve dhe programeve kompjuterike.

### FORMULARI 3: TRANSAKSIONE CASH NË ARKË

Në këtë formular, raportohen transaksionet *cash* të klientëve të bankës raportuese, të kryera pranë sporteleve (arkave) të saj, si depozitime apo tërheqje *cash*. Raportimi bëhet i ndarë sipas valutës së transaksionit: në LEK, EUR, USD apo valuta të tjera, si dhe i ndarë për llogaritë e bizneseve nga ato të individëve. Transaksionet raportohen të ndara sipas llojit të përcaktuar si më poshtë.

- I. Depozitime *cash* në arkë – në këtë rubrikë raportohen transaksionet *cash* në arkë me qëllim rritjen e gjendjes së llogarisë së klientit si dhe depozitime në llogari kursimi (me afat) të kryera në llogarinë e vetë apo në një llogari tjetër brenda bankës; dhe
- II. Tërheqje *cash* në arkë – këtu raportohen tërheqjet *cash* në arkë nga llogaria e klientit të bankës raportuese.

### FORMULARI 4: TRANSAKSIONE PERIODIKE NË SISTEM (BOOK ENTRY TRANSACTIONS)

Në formularin e katërt, raportohen transaksionet midis llogarive të bankës dhe klientit, në vijim të marrëveshjeve/kontratave të nënshkruara, si edhe transaksionet e rezultuara nga përdorimi i instrumenteve financiare. Raportimi bëhet i ndarë sipas valutës së transaksionit: në LEK, EUR, USD apo valuta të tjera. Transaksionet raportohen të ndara në dy kategori kryesore (me dy nënkategori për secilin zë), për llogaritë e bizneseve dhe të individëve.

- I. Transferta kreditimi – në këtë rubrikë raportohen kreditimet në llogarinë e klientit të bankës raportuese, të iniciuara nga vetë banka, pa përdorimin e një instrumenti transferte kreditimi. Këtu përfshihen: pagesat e interesave/dividendëve për klientët, disbursimi i kredive për klientët, marrëveshjet e depozitave, si dhe shitjet e letrave me vlerë dhe valutës, transaksione këto të autorizuara nga klienti paraprakisht, por për ekzekutimin e të cilave klienti nuk inicion urdhër transfertë; dhe
- II. Transferta debitimi – në këtë rubrikë raportohen debitimet në llogarinë e klientit të bankës raportuese, të iniciuara nga vetë banka, pa përdorimin e një instrumenti të debitimit direkt. Këtu përfshihen: transferimi i fondeve nga llogaria e klientit për shlyerjen e kartës së kreditit, shlyerjet e kësteve të kredisë, transferimi i fondeve në vijim të marrëveshjeve të depozitave, blerja e letrave me vlerë dhe valutës, si edhe të gjitha tipet e komisioneve për çdo instrument pagese dhe/ose transaksion të kryer, transaksione këto të autorizuara nga klienti paraprakisht.

## FORMULARI 5: KARTAT BANKARE

Në këtë formular raportohet numri total i kartave të emetuara nga banka raportuese dhe të vlefshme/aktive në periudhën e raportimit. Këtu raportohet numri total i kartave lëshuar klientëve, pavarësisht sa shpesh ato janë përdorur gjatë periudhës së raportimit apo nëse përdoren brenda ose jashtë vendit. Kartat të cilat janë të skaduara apo që nuk janë marrë në dorëzim nga klientët (joaktive), nuk përfshihen në këtë formular. Këtu përfshihen edhe kartat e lëshuara nga banka në bashkëpunim me kompanitë, nëse ka të tilla. Numri i kartave në qarkullim nuk llogaritet nëpërmjet llogarive të cilat këto karta mund të jenë të lidhura pasi ai mund të jetë më i lartë ose më i ulët se numri i kartave në qarkullim (si për shembull disa karta të lidhura me një llogari dhe e kundërta, një kartë e lidhur me më shumë se një llogari).

Nëse një kartë ofron më shumë se një funksion, ajo duhet raportuar në secilën prej rubrikave (I, II.1, II.2), sipas funksioneve që mbart. Përsa i përket numrit total të kartave të emetuara (rubrika IV e këtij formulari), çdo kartë raportohet vetëm një herë, pavarësisht funksioneve që mbart.

Numri i kartave raportohet i ndarë sipas funksionit, si më poshtë:

- I. Karta me funksion *cash*-i - në këtë rubrikë raportohet numri i kartave që i mundëson përdoruesit të saj të depozitojë ose të tërheqë *cash* nga një terminal në ATM;
- II. Karta me funksion pagese - raportohet numri i kartave të cilat mund të kenë funksion debiti apo debitimi të vonuar, krediti dhe *charge cards*, që i lejojnë mbajtësit të autorizuar të aksesojë në llogarinë e tij pranë emetuesit dhe/ose të përdorë një linjë krediti nga banka,

për të kryer pagesa për blerje apo shërbime. Raportimi bëhet i ndarë sipas funksionit të kartës: (1) me funksion debiti; (2) me funksion krediti, (3) me funksion debitim të vonuar (4) kartat me funksion *charge cards*;

- III. Karta me funksion para elektronike - raportohet numri i kartave të parapaguara të cilat mund të rimbushen dhe përdoren për një gamë të gjerë qëllimesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në këtë zë futen dhe (III.1) kartat me funksion para elektronike të cilat janë rimbushur të paktën një herë.
- IV. Numri total i kartave – raportohet numri total i kartave të lëshuara klientëve dhe të vlefshme për periudhën e raportimit, pavarësisht funksioneve që mbartin. Nga totali i kartave, në zërin IV.1 raportohet vetëm numri i kartave që kanë më shumë se një funksion.

Formulari 5 i kartave shoqërohet me informacion mbi operatorin e kartave të emetuara nga banka raportuese: karta lokale (emetuar nga vetë banka pa ndërmjetësinë e një operatori ndërkombëtar kartash), Visa, Master Card, American Express, apo Të tjera (operatorët e tjerë specifikohen nga vetë banka raportuese).

## FORMULARI 6: TERMINALET PËR PËRDORIMIN E KARTAVE DHE PARASË ELEKTRONIKE

Në formularin 6, raportohet numri total i terminaleve në operim që janë në pronësi dhe/ose të instaluara nga banka raportuese deri në fund të periudhës për të cilën raportohet. Këtu përfshihen: ATM, terminale POS, Virtual POS, si edhe terminalët për përdorimin e parasë elektronike. Nëse një terminal ATM ofron funksione të ndryshme, ai raportohet në secilën prej rubrikave sipas funksioneve që ofron (I.1, I.2, I.3). Ndërsa në numrin total të terminaleve (rubrika e I-rë, Formulari 6), çdo terminal raportohet vetëm një herë, pavarësisht funksioneve që mbart.

Numri i terminaleve raportohet i ndarë sipas tipologjive /funksioneve të mëposhtme:

- I. ATM - këtu raportohet numri total i ATM-ve të vendosura në përdorim që banka raportuese ka në pronësi. Nga numri total i terminaleve të ATM-ve, më poshtë raportohen terminalët në bazë të funksioneve që u ofrojnë mbajtësve të kartave:
  1. tërheqje *cash*;
  2. të kryejnë urdhër transferta; dhe
  3. kryerja e depozitave *cash*.
- II. Terminale POS (*Point Of Sale*) – këtu raportohet numri total i terminaleve POS/EFTPOS në pronësi dhe/ose të vendosura nga banka raportuese, të cilat mundësojnë përdorimin e kartave me funksion pagese pranë një pike shitjeje, me qëllim kryerjen e

pagesave elektronike. Nga totali i terminaleve POS, raportohen të ndara terminalët e mëposhtme:

1. terminalët me funksion tërheqje *cash*; dhe
  2. terminalët EFTPOS (*Electronic Funds Transfer Points of Sale*).
- III. Terminale Virtuale POS për përdorimin e kartave – këtu raportohet numri total i POS-eve virtuale të cilat nuk janë në formën e pajisjeve elektromekanike, të ofruara nga banka raportuese dhe që mundësojnë përdorimin e kartave për blerjet nëpërmjet internetit.
- IV. Terminalët për përdorimin e parasë elektronike – raportohet numri total i terminaleve që lejojnë përdorimin e parasë elektronike. Këto terminale ndahen në:
1. terminale për rimbushjen apo shkarkimin e tyre. Këto terminale lejojnë transferimin e fondeve elektronike nga emetuesi tek përdoruesi.
  2. terminale për kryerjen e pagesave me para elektronike. Terminalët në pikat e shitjes (*point of sale*), të cilat lejojnë transferimin e parasë elektronike nga karta tek tregtari ose tek balanca e tregtarit ose çdo përfitues tjetër.

## FORMULARI 7: STATISTIKA MBI NUMRIN E LLOGARIVE TË KLIENTËVE

Në formularin numër 7, raportohet numri total i llogarive të klientëve të cilat mund të përdoren për qëllime pagesash, numri i depozitave si dhe numri i klientëve të bankës raportuese, në fund të çdo periudhe raportimi. Nga totali i numrit të llogarive të klientëve, raportohet i ndarë numri i llogarive, numri i llogarive të aksesueshme nëpërmjet internetit, si dhe numri i llogarive të pagesave me shërbime bazike<sup>4</sup>. Gjithashtu, për qëllime studimore, llogaritë e klientëve raportohen të ndara në varësi të vendqëndrimit në Republikën e Shqipërisë apo jo të klientit, si dhe në varësi të llojit të llogarisë (individuale apo jo).

Në këtë formular raportohen edhe llogaritë e klientëve në funksion të përdorimit të parasë elektronike. Llogaritë, depozitat dhe llogaritë në funksion të parasë elektronike të klientëve raportohen të ndara sipas valutës së llogarisë në LEK, EUR, USD apo valuta të tjera.

## FORMULARI 8: STATISTIKA MBI MBAJTËSIT E KARTAVE

Në formularin 8 të raportimit, raportohet numri i kartëmbajtësve sipas grup-moshave të përcaktuara në formular, si edhe sipas gjinisë.

<sup>4</sup> Llogari e pagesave me shërbime bazike sipas përkufizimit në ligjin nr. 100/2023 "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike".

## FORMULARI 9: STATISTIKA MBI SHPËRNDARJEN RAJONALE TË TERMINALEVE

Në formularin 9 të raportimit, raportohet numri i terminaleve ATM/POS sipas shpërndarjes rajonale të degëve të Bankës së Shqipërisë, referuar tabelës së shpërndarjes rajonale të KIB.

## FORMULARI 10: TEPRICA E PARASË ELEKTRONIKE

Në formularin 10, raportohet teprica e parasë elektronike të emetuar nga bankat dhe të ruajtur në karta, kompjutera personalë, servera ose celularë. Teprica e parasë elektronike ndahet në:

- a) Tepricën e parasë elektronike *card-based* ku raportohet teprica e parasë elektronike e ruajtur në karta.
- b) Tepricën e parasë elektronike *computer-based* ku përfshihen:
  - i. *software-based*: raportohet teprica e parasë elektronike e ruajtur në produkte të cilat bazohen në programe të instaluar në kompjuter personal dhe të cilat mundësojnë transmetimin e vlerave elektronike nëpërmjet rrjeteve të telekomunikacionit si për shembull, interneti.
  - ii. *network-based*: raportohet teprica e parasë elektronike, me produkte të cilat ruajnë vlerën monetare në një server qendror. Kjo vlerë monetare përdoret për blerje në internet.
  - iii. *mobile-based*: raportohet teprica e parasë elektronike ku vlera monetare e parasë ruhet në pajisje celulare.

## FORMULARI 11: TRANSAKSIONET E PAGESAVE SIPAS LLOJIT TË AUTENTIFIKIMIT TË PËRDORUR

Formulari nr. 11 i raportimit hartohet në përputhje me rregulloren nr. 29, datë 1.6.2022 "Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit". Ky formular përbëhet nga 5 (pesë) rubrika/Kode, ku paraqiten numri dhe vlera e pagesave sipas instrumentit të përdorur për të kryer pagesën. Raportimi bëhet i ndarë sipas valutave: në ALL, EUR, USD dhe valuta të tjera, shprehur në milionë Lekë.

Këto rubrika përfshijnë kodet si më poshtë:

1. Transferta krediti të dërguara
2. Transaksione pagesash me karta të emetuara nga ofrues të shërbimeve të pagesave rezidentë (me përjashtim të kartave me funksion të parasë elektronike) - të dërguara
3. Transaksione pagesash me karta të pranuar nga ofrues të shërbimeve të pagesave rezidentë (me përjashtim të kartave me funksion të parasë elektronike) - të marra

4. Pagesa me para elektronike të emetuara nga ofrues të shërbimeve të pagesave rezidentë - të dërguara
5. Shërbime të inicimit të pagesës (shërbimi 7 sipas aneksit 1 të ligjit "Për shërbimet e pagesave").

Secila rubrikë më sipër raportohet sipas mënyrës së autentifikimit të përdorur për kryerjen e transaksionit/veprimit dhe është shumatore e dy kategorive: a) transaksione pagesash të autentifikuara sipas autentifikimit të thelluar të klientit (SCA) dhe b) transaksione pagesash që nuk autentifikohen sipas standardeve të autentifikimit të thelluar të klientit (SCA). Secila kategori ndahet më tej në veprime të iniciuara në distancë (*remote*) dhe ato të iniciuara jo në distancë (*non-remote*). Autentifikimi i thelluar i klientit zbatohet për rastet e parashikuara në pikën 1 të nenit 90 të ligjit 55/2020 "Për shërbimet e pagesave". Autentifikimi bazohet në dy ose më shumë elemente të pavarura, që kategorizohen si njohuri, posedim dhe qenësi, dhe rezultojnë në gjenerimin e një kodi autentifikimi.

Veprimet në distancë për të cilat nuk është kërkuar autentifikimi i thelluar i klientit, do të raportohen sipas arsyes së përjashtimit nga zbatimi i autentifikimit të thelluar të klientit, në përputhje me rregulloren 29/2022 të sipërpërmendur. Në rastet kur mund të zbatohet më shumë se një përjashtim, përjashtimi që është aplikuar është ai që duhet raportuar. Termat e përdorur si kritere të përjashtimit kanë të njëjtin kuptim me ato të përdorura në rregulloren 29/2022.

Konkretisht, për transaksionet e pagesave në distancë (*remote*) të ndara sipas arsyes së përjashtimit parashikohen nënkategoritë e detajuara si më poshtë:

- Transaksionet me vlerë të ulët (raportohet për kodet 1 deri në 4),
- Transaksione ndërmjet llogarive të mbajtura nga i njëjti person fizik ose juridik (raportohet vetëm për kodet 1 dhe 4),
- Transaksione me përfitues të besuar, (raportohet vetëm për kodet 1, 2 dhe 4),
- Transaksione të iniciuara nga tregtarët, (raportohet vetëm për kodet 2, 3 dhe 4)
- Transaksione të përsëritura (raportohet për kodet 1 deri në 4),
- Transaksione që përdorin proceset dhe protokollet e sigurta të pagesave të kompanive (raportohet vetëm për kodet 1, 2 dhe 4),
- Sipas analizës së rrezikut të transaksionit (raportohet për kodet 1 deri në 4),
- Të tjera (raportohet vetëm për kodet 2, 3 dhe 4).

Nënkategoritë e mësipërme janë përjashtuese nga njëra-tjetra (një veprim/transaksion pagese duhet të raportohet vetëm një herë në njërin nga këto nënkategoritë).

Ndërsa për transaksionet e pagesave jo në distancë (*non-remote*), të ndara sipas arsyes së përjashtimit parashikohen nënkategoritë e

detajuara si më poshtë:

- Transaksione ndërmjet llogarive të mbajtura nga i njëjti person fizik ose juridik (raportohet vetëm për kodin 1),
- Transaksione me përfitues të besuar (raportohet vetëm për kodet 1, 2 dhe 4),
- Transaksione të përsëritura (raportohet për kodet 1 deri në 4),
- Pagesat pa kontakt në pikën e shitjes (raportohet për kodet 1 deri në 4),
- Transaksionet në терминаlet e pambikëqyrura për pagesat e transportit dhe tarifat e parkimit (raportohet për kodet 1 deri në 4),
- Të tjera (raportohet vetëm për kodet 2, 3 dhe 4).

Edhe këtu, nënkategoritë e mësipërme janë reciprokisht përjashtuese nga njëra-tjetra dhe veprimet/transaksionet e pagesave raportohen vetëm një herë mbështetur në elementin përjashtues që është aplikuar për atë transaksion/veprim.

Numri dhe vlera e përgjithshme e transaksioneve të pagesave "të autentifikuara nëpërmjet jo-SCA" është shuma e nënndarjeve "transaksione në distancë (*remote*)" dhe "transaksione jo në distancë (*non-remote*)".

## V. Shpjegim i termave sipas kuptimit që kanë në këtë metodologji

Në zbatim të kësaj metodologjie, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Autentifikimi i thelluar i klientit (SCA)" siç përcaktohet në pikën 4 të nenit 5 të ligjit nr 55/2020 "Për shërbimet e pagesave";
- b) "Bankë" janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, që ushtrojnë veprimtari bankare dhe/ose financiare në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- c) "Batch" është një grup instruksione pagesash me vlerë të vogël dhe debitime direkt. Sistemi AECH pranon, përpunon dhe dërgon instruksione pagesash në *batch*;
- d) "Blue Book" është një publikim i Bankës Qendrore Evropiane "Për sistemet e pagesave dhe të shlyerjes së letrave me vlerë në BE, ku publikojnë treguesit statistikore për pagesat jo vetëm shtetet anëtare të BE-së, por edhe shtete të tjera jo-anëtare;
- e) "Çeku" është një urdhër me shkrim i lëshuar nga një palë (lëshuesi i çekut) për palën tjetër (përfituesi i çekut që zakonisht është një bankë), nëpërmjet të cilit i kërkohet bankës të paguajë një shumë të përcaktuar me paraqitjen e lëshuesit ose të një pale të tretë të përcaktuar nga lëshuesi;
- f) "Charge cards" e ngjashme me kartat e kreditit, përveç faktit se shlyerja e kredisë bëhet e plotë dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Për qëllime statistikore klasifikohen si karta krediti;
- g) "Debitim direkt" është një shërbim pagese për debitimin e llogarisë së pagesës së paguesit, ku një transaksion pagese inicihet nga përfituesi i pagesës, në bazë të pëlqimit që paguesi i ka



- dhënë përfituesit të pagesës, ofruesit të shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës ose ofruesit të shërbimit të pagesave të vetë paguesit. Zakonisht debitimi direkt është një pagesë e autorizuar paraprakisht, ku urdhëruesi autorizon pagesën përpara inicimit të saj dhe përdoret më së shumti në shlyerjen e detyrimeve që lindin nga përdorimi i shërbimeve publike (të tilla, si energji elektrike, ujë, telefon, gaz, etj), por jo vetëm;
- h) "Kartë" është një instrument pagese elektronike i emetuar nga një bankë që i mundëson mbajtësit, kundrejt një kontrate me shkrim, të kryejë transaksione me një ose më shumë funksione si: *cash*, para elektronike ose me funksione pagese. Kartat me funksion pagese, për qëllime statistikore, klasifikohen si karta debiti dhe karta krediti;
  - i) "Kartë debiti" i lejon mbajtësit të autorizuar të ketë akses në llogarinë e tij pranë emetuesit për të kryer blerje me fondet e disponueshme në këtë llogari si edhe për të tërhequr para *cash*, në rastet kur kjo kartë është e kombinuar me kartën me funksion *cash*;
  - j) "Kartë me debitim të vonuar" e ngjashme me kartat e debitit përveç faktit që shlyerja e pagesës në llogari bëhet në total, në një periudhë të përcaktuar kohe, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë;
  - k) "Kartë me funksion *cash*" mundëson përdorimin vetëm në ATM ose në makinat e *cash*-it dhe i lejon mbajtësit vetëm të tërheqë *cash*;
  - l) "Kartë krediti" i jep mundësinë mbajtësit të saj të përdorë një linjë krediti nëpërmjet së cilës mbajtësi mund të bëjë blerje dhe/ose të tërheqë *cash* deri në një kufi të paracaktuar. Sasia e lejuar e kreditit, si rregull shlyhet e plotë në fund të një periudhe të caktuar, ose mund të shlyhet pjesërisht dhe e shtyrë në kohë, në përputhje me termat e përcaktuar në kontratë;
  - m) "KIB" është një kod identifikues biznesi që identifikon qartë në nivel kombëtar një OSHP të licencuar për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky kod përcaktohet nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me OSHP sipas kësaj rregulloreje;
  - n) "Klient" është mbajtësi i një llogarie (titullar i llogarisë) në monedhë vendase apo të huaj, pranë një banke që ushtron aktivitet në Republikën e Shqipërisë;
  - o) "Llogaria e pagesës me shërbime bazike" ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 100/2023 "Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike";
  - p) "Ofrues i Shërbimeve të Pagesave - OSHP" ka të njëjtin kuptim me pikën 29, neni 5 i ligjit 55/2020, "Për shërbimet e pagesave";
  - q) "Pagesë" është një instruksion pa kushte për depozitim, tërheqje apo transferim fondesh, iniciuar nga urdhëruesi/(përfituesi) për tek banka e përfituesit/(banka e urdhëruesit), e transmetuar në formë elektronike apo letër, me qëllim vendosjen e fondeve në dispozicion të përfituesit. Një pagesë mund të kryhet edhe në rastet kur urdhëruesi dhe përfituesi është i njëjti person;
  - r) "Pagesë me kartë" është një transaksion pagese që kryhet me anë të një kartë bankare në një terminal ose në kanale të tjera komunikimi;

- s) "Para elektronike" është një instrument pagese, i ndryshëm nga instrumenti i pagesave në distancë, i cili ruan vlera monetare në formë elektronike dhe që i mundëson mbajtësit të kryejë pagesa elektronike. Ky instrument mund të rimbushet me vlera monetare sa herë është e nevojshme;
- t) "Përfitues të besuar" - paguesi krijon ose ndryshon një listë të përfituesve të besuar përmes OSHP për shërbimin e llogarisë së paguesit;
- u) "Red Book" është një publikim i prodhuar nga Komiteti i Sistemeve të Pagesave dhe Shlyerjes, pranë Bankës për Shlyerje Ndërkombëtare (BIS). Qëllimi është që të sigurohet një përshkrim gjithëpërfshirës i sistemeve të pagesave të një shteti;
- v) "Terminal" është një pajisje elektromekanike, e cila bën të mundur tërheqjen, depozitimin e parasë *cash* apo transferimin e fondeve ndërmjet llogarive, nxjerrje llogarie, apo përdorimin e kartave në një pikë shitjeje, etj. Terminalet operojnë si në regjim online, ku baza e të dhënave aksesohet në kohë reale, ashtu edhe në regjim offline, ku procesimi dhe aprovimi i një transaksioni në një terminal bëhet pa kontaktuar ndërkohë emetuesin;
- w) "Transaksion i përsëritur" një seri transaksionesh të përsëritura, me të njëjtin shumë dhe me të njëjtin përfitues;
- x) "Transaksion me vlerë të ulët" ka të njëjtin kuptim me termin e përdorur në rregulloren nr. 29 datë 1.6.2022 "Për autentifikimin e thelluar të klientit dhe standardet e përbashkëta, të hapura dhe të sigurta të komunikimit";
- y) "Transaksion pagese në distancë" ka të njëjtin kuptim me pikën 46, neni 5 i ligjit 55/2020, "Për shërbimet e pagesave";
- z) "Transfertë debitimi" është një pagesë e autorizuar nga urdhëruesi dhe e iniciuar nga përfituesi, pranë bankës së përfituesit. Në një transfertë debitimi, urdhri i pagesës lëviz nga banka e përfituesit për tek banka e urdhëruesit, ndërsa fondet lëvizin nga banka e urdhëruesit për tek banka e përfituesit. Një ose disa banka dhe/ose sisteme pagesash, mund të jenë të përfshira në një transfertë debitimi;
- aa) "Transfertë kreditimi" është një pagesë e iniciuar nga urdhëruesi, pranë bankës së urdhëruesit, me qëllim vendosjen e fondeve në dispozicion të përfituesit. Në një transfertë kreditimi, si urdhri i pagesës ashtu edhe fondet lëvizin nga banka e urdhëruesit për tek banka e përfituesit. Një ose disa banka dhe/ose sisteme pagesash mund të jenë të përfshira në një transfertë kreditimi;





## Transaksionet sipas tipit dhe terminaleve F2

Emri i Entitetit

Data e Raportimit

Rubrika	Përshkrimi	Transaksionet	
		Numër	Vlera
I	<b>Transaksione në terminallet e instaluara në vend, me karta dhe para elektronike të emetuar nga banka raportuese</b>		
	1- ATM tërheqje cash		
	2- ATM depozitime		
	3- Transferë fondesh nëpërmjet ATM-ve		
	4- Tërheqje cash në terminale POS		
	5- Paguesa me karta në terminale POS		
	6-Transaksione për mbushjen, rimbushjen ose tërheqjen e vlerës së mbetur të parasë elektronike nga të cilat:		
	a-me karta		
	b-me software		
	7-Paguesa me para elektronike nga të cilat:		
	a-me karta		
	b-me software		
II	<b>Transaksione në terminallet e instaluara jashtë vendit, me karta dhe para elektronike të emetuara nga banka raportuese</b>		
	1- ATM tërheqje cash		
	2- Transferë fondesh nëpërmjet ATM-ve		
	3- Tërheqje cash në terminale POS		
	4- Paguesa me karta në terminale POS		
	5-Transaksione për mbushjen, rimbushjen ose tërheqjen e vlerës së mbetur të parasë elektronike nga të cilat:		
	a-me karta		
	b-me software		
	6-Paguesa me para elektronike nga të cilat:		
	a-me karta		
	b-me software		
III	<b>Transaksione në terminallet e instaluara nga banka raportuese, me karta dhe para elektronike të emetuara nga banka jashtë vendit</b>		
	1- ATM tërheqje cash		
	2- ATM depozitime		
	3- Tërheqje cash në terminale POS		
	4- Paguesa me karta në terminale POS		
	5-Transaksione për mbushjen, rimbushjen ose tërheqjen e vlerës së mbetur të parasë elektronike nga të cilat:		
	a-me karta		
	b-me software		
	6-Paguesa me para elektronike nga të cilat:		
	a-me karta		
	b-me software		



**Kartat bankare F5**  
Emri i Entitetit  
Data e Raportimit

Rubrika	Numri i Kartave sipas funksioneve/operatorëve	karte lokale	VISA	MasterCard	Americ.Express	Tjera*	Totali
I	<b>Karta me funksion cash-i</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
II	<b>Karta me funksion pagese</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	prej të cilave:						
	1- Karta me funksion debiti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	2- Karta me funksion krediti	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	3- Kartë me funksion debitimi të vonuar ( <i>Delayed debit card function</i> )	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	4- <i>Charge Card</i>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
III	<b>Karta me funksion para elektronike</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	prej të cilave:						
	1- Karta me funksion para elektronike me rimbushje të paktën një herë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
IV	<b>Numri total i kartave</b>	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	prej të cilave:						
	1- karta me më shumë se një funksion	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

\* në këtë zë përfshihen llojet e kartave që nuk janë parashikuar në zërat e cituar, banka specifikon emërtimin e saj

**Terminalet për kartat dhe paranë elektronike F6**  
Emri i Entitetit  
Data e Raportimit

Rubrika	Përshkrimi	Numër
I	<b>Automated Teller Machines (ATM) - sipas funksionit</b>	0.00
	prej të cilave:	
	1 - ATM me funksion tërheqje cash	0.00
	2 - ATM me funksion urdhër transfera	0.00
	3 - ATM me funksion depozitim cash	0.00
II	<b>Terminale POS (Point of Sale)</b>	0.00
	prej të cilave :	
	1- terminale POS me funksion tërheqje cash	0.00
	2- terminale EFTPOS	0.00
III	<b>Terminale virtuale POS per perdorimin e kartave</b>	
IV	<b>Terminale për përdorimin e parasë elektronike</b>	0.00
	Prej të cilave:	
	1-terminale për rimbushjen apo shkarkimin e parasë elektronike	0.00
	2-terminale për kryerjen e pagesave me para elektronike	0.00

**Statistika F7 & F8 & F9**  
Emri i Entitetit  
Data e Raportimit

F7. Statistika mbi numrin e llogarive të klientëve

Përshkrimi	Numër				Totali	Nga të cilat: numri i llogarive të klientëve të aksesueshme nga interneti
	ALL	EUR	USD	Valuta të tjera		
<b>I. Llogaritë e klientëve (1+2)</b>						
<b>1- Llogari të rezidentëve (a+b)</b>						
a - individuale						
b - kompani						
<b>2- Llogari të jo rezidentëve (a+b)</b>						
a - individuale						
b - kompani						
Numri i llogarive të pagesave me shërbime bazike *						
Numri i llogarive të parasë elektronike						
<b>II. Depozita e klientëve (1+2)</b>						
<b>1- Depozita të rezidentëve (a+b)</b>						
a - individuale						
b - kompani						
<b>2- Depozita të jo rezidentëve (a+b)</b>						
a - individuale						
b - kompani						
<b>III. Numri total i klientëve</b>						
<b>1- Rezident (a+b)</b>						
a - individë						
b - kompani						
<b>2- Jo rezidentë (a+b)</b>						
a - individë						
b - kompani						

\* Sipas përcaktimeve të ligjit "Për llogaritë e pagesave me shërbime bazike"



### F8. Statistika mbi mbajtësit e kartave

Kartat sipas gjinisë / grup-moshës së mbajtësit:	Numër					Totali
	18-25	26-35	36-45	46-55	56+	
Totali						
1- femra						
2- meshkuj						

### F9. Statistika mbi shpërndarjen rajonale të terminaleve

Përshkrimi	Numër						Total
	Tirana	Shkodra	Korça	Gjirokastra	Elbasani	Lushnja	
Shpërndarja rajonale e terminaleve							
1- ATM të instaluar							
2- POS-e të instaluar							

### Teprica e parasë elektronike Teprica e parasë elektronike

F10

Emri i Entitetit

Data e Raportimit

Rubrika	Përshkrimi	ALL	Euro	Në valuta të tjera	Totali i gjithë monedhave
I	Teprica e parasë elektronike e ruajtur në produkte:	0.00	0.00	0.00	0.00
	a) <i>Card-based</i>	0.00	0.00	0.00	0.00
	b) <i>Computer-based</i>	0.00	0.00	0.00	0.00
	nga të cilat:				
	i) <i>software-based</i>	0.00	0.00	0.00	0.00
	ii) <i>network-based</i>	0.00	0.00	0.00	0.00
	iii) <i>mobile-based</i>	0.00	0.00	0.00	0.00





